Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0173

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje ngaVedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Doctor Exterminator DDD SH.P.K., dhe ankesës së (OE) "Flomed" SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit të Policise se Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, me datë 26/04/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar ankesa e OE "Doctor Exterminator DDD SH.P.K me nr. 2024/0173, e datës 28.02.2024, kurse vendimi i AK- Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, **te mbetet në fuqi.**

2. **Hedhet poshtë** si e palejuar ankesa e Operatorit ekonomik (OE) "Flomed" SH.P.K e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 29.02.2024, numër protokolli 2024/0180, për aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore" me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-së

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Doctor Exterminator" DDD SH.P.K

5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Flomed" SH.P.K

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 31.05.2022 Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në Objektet Policore- vazhdim afati 6" me numër të prokurimit"214-22-5200-2-1-1".

Me 13.02.2024 datën ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues njoftimin për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë "Grupin e Operatorëve S.V Veterina & N.N.P Wenda."

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë , me një operator, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 379,614.27 €.

Me16.02.2024, OE "Doctor Exterminator" DDD SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.02.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të "Doctor Exterminator" DDD SH.P.K. Poashtu me datën 16.02.2024 kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar edhe OE "Flomed" SH.P.K e cila është refuzuar me vendimin e AK-së të datës 23.02.2024.

Me datën: 28.02.2024, OE "Doctor Exterminator DDD SH.P.K.", ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0173 i pakënaqur me vendimin e AK-së. Poashtu me datën 29.02.2024 ankesë kundër vendimit të AK për dhënie të kontratës ka parashtruar edhe OE "Flomed SHPK".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesave, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 173/24 dhe ankesa nr. 180/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

1. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE "Doctor Exterminator" DDD SH.P.K

Përgjigjja në pretendimet ankimore të OE "Doctor Exterminator DDD"- Prishtinë

Ne lidhje me pretendimin se AK ka shkelur nenin 6 te LPP, nuk qëndron pasi AK, të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe

lëndën e prokurimit. Ne këtë aktivitet te prokurimi Autoriteti kontraktues duke marre ne konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit fondet publike i ka përdorë ne mënyrën ekonomike pasi që Grupi i Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për kontrate i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë si ofertë e përgjegjshëm me Çmimin më të ulët ndërsa Oferta e juaj është e përgjegjshme me çmime me të lartë se oferta e rekomanduar për kontratë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ku të gjithë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në ketë aktivitetit i ka trajtuar të barabartë. Poashtu AK, katastrofë 5C gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: vi) që tenderi i zgjedhur te përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse pasi që oferta e rekomanduar për kontrate i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate. Andaj, Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate si dhe ka rekomanduar për kontratë Grupin e OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Andaj, komisioni i vlerësimit te ofertave te gjithë ofertuesit duke ju përfshirë edhe juve si ankues ju kanë trajtuar të. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigja e dytë: AK në dosje të tenderit ka kërkuar: Kërkesën l. Regjistrimi si operator ekonomik ne regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet te regjistroj përfaqësim në Kosovë para nënshkrimit të kontratës). Ndërsa si dëshmi. Dëshmia 1. Kopja c certifikatës së regjistrimit te biznesit. Nga kjo shihet se në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate nuk është kërkuar që të dëshmohet informatat me kode të veprimtarisë së kompanisë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigja në AK ju njofton se në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE, leja për importit ka qene vailide mirëpo për shkak se lënda ka qene në OSHP dhe në seancën e mbajtur një nder pikat ka qene vlefshmëria e Lejeve te importit për produkte biocide. Autoriteti Kontraktues sipas vendimit te OSHP-së gjatë rivlerësimit te ofertave ju ka kërkuar te gjithë OE ekonomik qe kane vazhduar validitetin e ofertave si dhe sigurimin e ofertës kërkuar sqarime shtese për te dëshmuar lejen për import me validitet si dhe sqarime tjera konform vendimit te OSHP-së. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigja në pretendim: AK ju njofton se në kohen kur oferta është dorëzuar nga grupi i OE ISO 9001 2015 ka qenë valide.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE ka dorëzuar listën e stafit ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate ku janë kërkuar minimum 3 punëtorë teknike me eksperiencë e DDD-së. Për këta tre punëtorë janë dorëzuar referenca si dhe kontrata/ para kontrata për projektin ne Qalë. Sa i për këtë referencave qe me dorëzimin e ofertës janë te pa nënshkruar dhe të pa vulosura po ashtu andaj, ky pretendim është shqyrtuar edhe me vendimin e OSHP-së ku janë kërkuar sqarime shtese nga OE. Për punëtorin Mithat Eminoviç ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate si kriter nuk është kërkuar ne

listën e stafit profesional Epidemilog. Sa i përket sqarimeve te kërkuara nga AK, këto sqarime janë edhe sipas vendimit te OSHP-se ku kërkohet qe AK gjatë rivlerësimit të sqarohen referencat që janë të pa nënshkruar. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë. Kërkesën I: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, në qarkullim vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 200,000.00 euro. Ndërsa si dëshmi. Dëshmia 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit prej jo me pak se 200,000.00 euro.

Sipas këtij pretendimi ankimor nga OE ankues ju informojmë AK ka kërkuar qe OE te dëshmoj me Deklaratat Tatimore Vjetore nga ATK për tri vitet e fundit dhe grupi i OE këtë dëshmi i ka dorëzuar ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë. Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara në vlerë prej 100,000.00 f deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Dëshminë 2. Një Listë e Shërbimeve të natyrës se ngjashme te realizuara në tri vitet e shkuara duke saktësuar Shërbimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr. e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal) të dëshmuara me referenca pozitive ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses (kopje). Sipas këtij pretendimi ankimor nga OE ankues ju informojmë AK ka kërkuar qe OE te dorëzoj një listës te shërbimeve te natyrës se ngjashme dhe grupi i OE kane dorëzuar listën e kontratave te realizuara. Grupi i OE sipas listës se kontratave dhe referencave kane dëshmuar se e tejkalojnë vlerën e kërkuar sipas kriterit te larte shënuar me referenca për shërbimet e kryera. Ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nuk është kërkuar qe lideri i grupit për vlerën e kontratave te realizuara prej 100,000.006 ti ketë 60% te vlerës se kontratave te realizuar. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigja në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë: Kërkesa 3. OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim. Dëshmia 3. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë se punës dhe preparatet për realizimin e shërbimeve. Vërejtje të gjitha preparatet e parapara duhet te jenë të lejuara me ligj. Sipas këtij pretendimi ankimor nga OE ankues ju informojmë grupi i OE te rekomanduar kane dorëzuar metodologjinë e punës ku është e nënshkruar nga OE S.V. Veterina ku nuk është kërkuar te jete - vulosur dhe i nënshkruar nga secili anëtar i konzerciumit. Po ashtu ne katalogun e dorëzuar janë të specifikuara preparatet qe do të përdoren për dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë Kërkesa 4. OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosni nga OE në pajisjet ne vijim. Se paku i pompës motorike-Gjenerator ULV. Së paku 5 pompës motorike dhe pajisje te tjera përcjellës. Ndërsa si dëshmi: Dëshmia 4. OE duhet të ofrojë listën e pajisjeve të kërkuara për kryerjen e shërbimeve nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Në rast se këto pajisje janë të vetat, atëherë duhet të dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre, nëse janë të ndara dhe qira atëherë te dëshmohet me marrëveshje mbi marrjen me qira për projektin në fjalë. Sipas pretendimit ankimor nga OE ankues ju informojmë grupi i

OE te rekomanduar ka dorëzuar listën e pajisjeve te kërkuara sipas dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate. AK si kriter te lista e pajisjeve nuk ka kërkuar pajisje ULV - Es Elektrostatike po ashtu Grupi i OE te rekomanduar për kontrate ka nënshkruar deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike Aneksi 1 - FDT. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Përgjigje në pretendim: AK ju njofton se në dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar si kërkesë Kërkesa 5. Lejen e Importit për produkte biocidc insekticide të lëshuar nga autoritetet relevante. Dëshmimi 5. Leja për biocidc insekticid të lëshuar nga autoritet relevante kopje. Sipas pretendimi ankimor nga OE ankues ju informojmë se gjate rivlerësimit te ofertave te gjithë OE përmes sqarimeve ju është kërkuar Leja e importeve pasi qe këto leje kane qene te skaduara dhe kjo pike është sqaruar edhe me Vendimin e OSHP-së ku është kërkuar qe gjate rivlerësimit përmes sqarimeve te kërkohen lejet qe janë te skaduar. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar

2. Pretendimet ankimore të "Doctor Exterminator DDD" SH.P.K në ankesën 0173/24

Pretendimi i parë (I): Pretendimi i parë i OE që ka të bëjë me Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale me FDT është kërkuar: Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës). Dëshmia 1. Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit.

Pretendimi i dytë (II): Pretendimi i dyte dhe peste qe kane te bëjnë me te njëjtin pretendim për lejen e produkteve biocide me Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar: Kërkesa 5. Leja e Importit për produkte biocide insekticide të lëshuar nga autoritet relevante. Dëshmia 5. Leja për biocide insekticid të lëshuar nga autoritetet relevante kopje. OE ankues në pretendimin e tij deklaron se OE i rekomanduar për kontrate nuk posedon Lejen e importit dhe se i mungon faqja e dyte. Eksperti shqyrtues gjatë administrimit te provave te përgjigjes ne kërkesën për sqarim te dërguar me datën 06.01.2024 OE i rekomanduar për kontrate ka bashkangjitur lejen e importit për produkte biocide me nr. 5294-2/23 te lëshuar nga MMPHI e cila ka 3 faqe dhe ne faqen e dyte posedon edhe tabelën e produkteve biocide.

Pretendimi i tretë (III): Pretendimi i tretë i OE ka të bëjë me Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale me FDT është kërkuar:Kërkesa 6. Të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 2015 për cilësinë e shërbimeve te DDD nga një kompani e licencuar.Dëshmia 6. Standardi ISO 9001 2015 valide (e noterizuar).

Pretendimi i katërt (IV): Pretendimi i katërt ka të bëjë me kërkesën për: Kërkesa 1. Stafi profesional për shërbimet e DDD: 3 Punëtorë teknik. Dëshmia 1. Listën e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE. Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.

Pretendimi i gjashtë (VI): Ky pretendim ankimor i OE ankues qe ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas FDT është kërkuar: Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 200,000.00 euro. Dëshmia 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës

për tri vitet e fundit prej jo më pak se 200.000.00 euro. Pretendimi i OE ankues se qarkullimi është dashur te jete nga aktiviteti i njëjtë apo i ngjashëm nuk qëndron sepse me FDT është kërkuar qe qarkullimi te dëshmohet me deklaratat tatimore vjetore te cilat GOE te rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar ne përputhje me kërkesat e FTD.

Pretendimi i shtatë (VII): Pretendimi i shtatë e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes së tenderit është kërkuar: Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara në vlerë prej 100,000.00 € deri në publikimin e njoftimit për kontratë. Dëshmia 2. Një Listë e Shërbimeve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke saktësuar Shërbimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr. e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), të dëshmuara me referenca pozitive ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses (kopje). Pretendimi ankimor i OE ankues se dëshmitë e dorëzuara nuk janë te pranueshme sepse lideri nuk posedon 60% te referencave nuk qëndron sepse një kërkese e tille nuk është kërkuar me dosje te tenderit sipas kërkesës 9.1 & 9.2. Sa i përket pjesës se pretendimit se GOE nuk e plotëson kërkesën sepse kontratat nuk kane te bëjnë me aktivitetin e DDD-se eksperti shqyrtues sqaron se me FDT është kërkuar "te ngjashme".

Pretendimi i tetë (VIII): Ky pretendim i OE ankues ka të bëjë me kërkesat teknike profesionale sipas dosjes së tenderit është kërkuar: Kërkesa 3. OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim. Dëshmia 3. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë se punës dhe preparatet për realizimin e shërbimeve. Vërejtje të gjitha preparatet e parapara duhet të jenë të lejuara me ligj. Sa i përket metodologjisë se punës dhe pretendimit se nuk është nënshkruar, eksperti shqyrtues vlerëson se marrëveshja e GOE e emëron si udhëheqës te grupit OE SV Veterina dhe se sipas marrëveshjes.

Pretendimi i nëntë (IX): Sipas fakteve te gjetura OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar listën e pajisjeve te kërkuar sipas specifikave te DT si dhe ka dëshmuar me foto dhe deklarate për këto pajisje.Në këtë rast, "ULV" përbën një akronim për "Ultra Low Volume" (Volum Ekstrem i Ulet). Në këtë kontekst "gjeneratori ULV" mund të referohet në një pajisje të përdorur për shpërndarjen e lëngjeve të ndryshme në mënyrë të financuar, si pesticide, dezinfektante, ose produkte të ngjashme, në një formë të shpërndarjes së shumicës së vogël.Për të ndërtuar një gjenerator ULV të paktën me 5 pompa motorike dhe pajisje të tjera. Gjenerator ULV bazë: Kjo do të jetë baza e pajisjes, e cila përfshin dyqanin e lëngut, mekanizmin për shpërndarjen e lëngut, dhe sistemin e kontrollit.

Pretendimi i dhjetë dhe njëmbëdhjetë: Ky pretendim i OE ankues qe ka te beje me lejen e importit te OE te rekomanduar për kontrate eksperti shqyrtues vlerëson se i është dhënë përgjigje ne pretendimin 2 ku është cek se leja e bashkangjitur ka 3 faqe dhe posedon listën e biocideve. Sa i përket pjesës ku OE ankues deklaron se OE i rekomanduar nuk posedon citoj "Sa i përket Dezinsektimit gjithashtu kërkohet leja e importit te produkteve nga Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI). OE nuk posedon leje te importit".

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/03/2024 ka autorizuar eksperten për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 173/2024, dheështë dorëzuar raporti i ekspertit me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

3. Lidhur me pretendimet e OE "Doctor Exterminator DDD SH.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/173 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues se është dashur ti ketë kodet e veprimtarisë GOE te rekomanduar për kontrate nuk është i qëndrueshëm sepse sipas FDT nuk është kërkuar ne mënyrë specifike qe te dëshmohen përmes kodit te veprimtarisë, prandaj AK-ja ne këtë pike ka vepruar ne përputhje me nenin 40.2 dhe 40.12 te RRPP 001/2022, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II) dhe i psetë (V): OE ankues në pretendimin e tij deklaron se OE i rekomanduar për kontrate nuk posedon Lejen e importit dhe se i mungon faqja e dyte. Eksperti shqyrtues gjatë administrimit te provave te përgjigjes ne kërkesën për sqarim te dërguar me datën 06.01.2024 OE i rekomanduar për kontrate ka bashkangjitur lejen e importit për produkte biocide me nr. 5294-2/23 te lëshuar nga MMPHI e cila ka 3 faqe dhe ne faqen e dyte posedon edhe tabelën e produkteve biocide. Prandaj duke pas parasysh provat e administruara eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ne këtë rast ka vepruar ne përputhje me nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe se pretendimi në këtë pikë nuk është i bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate nuk e posedon ISO 9001 2015 për kontrollin e gjarpërinj nuk është i qëndrueshëm sepse me dosje te tenderit nuk është kërkuar një certifikim specifik sikurse e pretenduar, ndërsa ISO 9001 2015 gjate dorëzimit te ofertave ka qene valide. Vetëm për qëllime te sqarimit te pretendimit se kompania e cila ka certifikuar OE e rekomanduar për kontrate ka tërhequr certifikatën eksperti shqyrtues ka kërkuar ne webfaqen e dhënë ne pretendim në të cilën ka gjetur se ISO standardi është valid. Eksperti shqyrtues me qellim te verifikimit te mëtejshëm te pretendimit ka kërkuar ne https://www.iafcertsearch.org/certification/ ne te cilën rezulton se certifikata është valide. Prandaj bazuar ne sqarimet dhe dëshmitë si me larte eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor ne këtë pikë nuk është i bazuar.

Konstatimi i katërt (IV): Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues ne lidhje me kontratat e punëtorëve, referencat dhe deklaratën se OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar dëshmitë pa kërkesë për informacione shtese nuk është i qëndrueshëm sepse AK-ja me datën 03.01.2024 ka dërguar kërkesë për sqarim nder te tjera edhe për pjesën e referencave dhe kontratave te cilës OE i rekomanduar për kontrate ju ka përgjigjur me datën 06.01.2024 duke dërguar te gjitha dëshmitë e kërkuara. Vlen te theksohet se kjo është rekomanduar edhe me vendimin e PSH 2023/605. Ndërsa sa i përket pjesës se pretendimit ku i referohet personelit te AK-se epidemiologut me iniciale M.E dhe nostrifikimit te diplomës se tij eksperti shqyrtues konstaton se me FDT nuk është kërkuar qe OE-te te kenë epidemiolog dhe se pretendimi nuk qëndron. Prandaj bazuar ne dëshmitë (letrat standarde) eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka vepruar ne përputhje me nenin 59.2 dhe 72 si dhe nenin 59 të LPP-se dhe se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Konstatimi i gjashtë (VI): Pretendimi i OE ankues se qarkullimi është dashur te jete nga aktiviteti i njëjtë apo i ngjashëm nuk qëndron sepse me FDT është kërkuar qe qarkullimi te dëshmohet me deklaratat tatimore vjetore te cilat GOE te rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar ne përputhje me kërkesat e FTD. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ne këtë pike ka vepruar ne përputhje me nenin 40 te RRPP 001/2022 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Konstatimi i shtatë (VII): Pretendimi ankimor i OE ankues se dëshmitë e dorëzuara nuk janë te pranueshme sepse lideri nuk posedon 60% te referencave nuk qëndron sepse një kërkese e tille nuk është kërkuar me dosje te tenderit sipas kërkesës 9.1 & 9.2. Sa i përket pjesës se pretendimit se GOE nuk e plotëson kërkesën sepse kontratat nuk kane te bëjnë me aktivitetin e DDD-se eksperti shqyrtues sqaron se me FDT është kërkuar "te ngjashme" dhe se në bazë të Opinionit te dhënë nga KRPP te datës 09.06.2023 me nr. 9 citoj "Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik. Prandaj bazuar ne opinionin e KRPP dhe kërkesën e FTD eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka vepruar në përputhje me Opinionin e KRPP dhe se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Konstatimi i tetë (VIII): Sa i përket metodologjisë se punës dhe pretendimit se nuk është nënshkruar, eksperti shqyrtues vlerëson se marrëveshja e GOE e emëron si udhëheqës te grupit OE SV Veterina dhe se sipas marrëveshjes: Prandaj pretendimi nuk është i qëndrueshëm, ndërsa pjesa e pretendimit qe ka te beje me preparatet e GOE te rekomanduar për kontrate eksperti shqyrtues vlerëson se është shtjelluar dhe sqaruar gjate seancës dëgjimore të ankesës 2023/605 dhe se konsideron se kjo është çështje e gjykuar (res-judicata).

Konstatimi i nëntë (IX): Në këtë rast, "ULV" përbën një akronim për "Ultra Loë Volume" (Volum Ekstrem i Ulet). Në këtë kontekst, "gjeneratori ULV" mund të referohet në një pajisje të përdorur për shpërndarjen e lëngjeve të ndryshme në mënyrë të financuar, si pesticide, dezinfektantë, ose produkte të ngjashme, në një formë të shpërndarjes së shumicës së vogël. Për të ndërtuar një gjenerator ULV të paktën me 5 pompa motorike dhe pajisje të tjera. Gjenerator ULV bazë: Kjo do të jetë baza e pajisjes, e cila përfshin dyqanin e lëngut, mekanizmin për shpërndarjen e lëngut, dhe sistemin e kontrollit. Prandaj eksperti vlerëson se pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

Konstatimi i dhjetë (X) dhe njëmbëdhjetë (XI): Sa i përket pjesës ku OE ankues deklaron se OE i rekomanduar nuk posedon citoj "Sa i përket Dezinfektimit gjithashtu kërkohet leja e importit te produkteve nga Ministria e Ambientit Hapësinor (MMPHI). OE nuk posedon leje te importit". Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nuk qëndron sepse ne lejen e importit te lëshuar nga MPBZH ceket. Vlen te theksohet se OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontrate posedojnë lejet e importit te lëshuara nga dy institucionet MMPHI dhe MPBZH te cilat kane tekstin e njëjtë ne përshkrimin e lejes prandaj duke pas parasysh përgjigjen ne pretendimin 2 eksperti shqyrtues

vlerëson se këtij pretendimi i është dhënë përgjigje.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE deklaron se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues në ankesat 173/24 në bazë të rekomandimit të ekspertit teknik dhe profesioanl konstatoj se aktiviteti i prokurimit duhet të mbetet në fuqi dhe ankesa të refuzohet.

Paneli shqyrtues konstaton se Ankesa Nr. 180/24 hedhet si e palejuar sepse për këtë aktivitet të prokurimit Ankuesi (më të dhëna të cekura si më lartë) është palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, për shkak se me vendimin e autoritetit kontraktues të datës 10.08.2023 në fazën paraprake, i njëjti është pajtuar me anulim të aktivitetit të prokurimit dhe nuk ka parashtruar ankesë kundër anulimit te datës 10/08/2023 d.t.th është pajtuar me këtë anulim dhe nuk ka qenë palë në procedurat e më vonshme në OSHP duke pretenduar që me qenë fitues i kësaj kontrate. Ky aktivitet i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim vetëm në bazë të ankesave me nr. 2023/0605 dhe 2023/0612, të cilët e kanë atakuar vendimin e AK të datës 10/08/2023 dhe në bazë të këtyre ankesave që kanë qenë kundër anulimit të këtij aktivitetit të prokurimit është kthyer lënda në ri-vlerësim.

Në fakt (pavarësisht nga rekomandimet), Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportet e ekspertit shqyrtues profesional dhe teknik, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues profesional dhe ekspertit teknik, janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish.

Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me nr. 2024/0173, që ankesa të refuzohet, ndërsa të

mbetet në fuqi vendimi i AK, ngase në bazë të përgjigjeve të pretendimeve ankimore, disa prej tyre janë të qëndrueshme mirepo bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertëve, pasi qe kjo lëndë është përseritur që disa **herë** dhe konform Rregullores se Punes se OSHP-së konkretisht neni 16.3 cituar, ne rastet e perseritur me pretendime te njejta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palet jane te njejta, për rastet te cilat janë shqyrtuar më parë, paneli shqyrtues duhet te trajtoj si çështje te gjykuara "res judikata" ne kuptim te nenit 105.2.16 te LPP-së. Në këtë rast jo të gjitha pretendimet janë të njëjta por ankuesit dhe materia e kësaj lënde është gjykuar disa herë, vendimet e OSHP-se për këtë aktivitet 677/22, 2023/0056, 2023/0086/, 2023/0283, 2023/0292, 2023/0440, 2023/0605, 2023/0612 dhe së fundmi e këto dy ankesat e fundit 2024/0173 dhe 2024/0180.

Paneli Shqyrtues me fjalë tjera konsideron se AK ka ri-vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe AK e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operator ekonomik" si dhe neni 59 par. 4 LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmërinë me të gjitha gjërat e parashtruara në njoftimin e kontratave dhe në dosjet e tenderit", duke ju përmbajtur kriteret e përgjegjësive. juridike qe lidhur me njoftimin per kontratat dhe dosjet se tenderit duke respektuar kriteret e dhënies, tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si dhe është respektuar edhe neni 60 i LPP-së. Andaj paneli marr parasysh natyrën e ndjeshme të aktivitetit konsideron që ky aktivitet është vlerësuar në pajtim me vendimiet paraprak Nr. 2023/0605, 2023/612 i dt: 01.12.2023, ku jane analizuar dhe sqaruar te gjitha problemet dhe faktet e lidhura me netyren e ketij aktiviteti te prokurimit, ku AK ka qene i ogliguar te analizoj dhe vleresoj te gjitha dokumentet ne pajtim me dispozitat. ligjore te nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, si dhe kete fakt e ka argumentuar edhe eksperti shqyrtues ne raportin e tij, me te provave dhe fakteve konkrete, dhe te drejte paneli vendosi si ne dispozitiv te mos vendimit.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së, AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të pasi OE, duke u mbajtur gjithë dokumentacionin e tyre dhe dëshmitë e dëshmuara me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshme. Paneli Shqyrtues vlerëson se komentet e tenderit janë kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratave dhe dosjeve të tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejtë ka shpërblyer OE është rekomanduar pasi ka vendosur të gjitha këto parashtruara në dosjet e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm çmimin me të lirë.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtën AK dhe që do të jetë në fuqi vendimin e AK, vendim ky që është vendimi i një komisioni i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës", atëherë në përbimë të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta zgjasë aktivitetin e prokurimit. Edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përfundim të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për

kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka. pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i ligjit është mes tjerash, cituar: "...të sigurtë integritetin dhe përgjegjësinë e tyre. zyrtarëve, nëpunësve civilë dhe të tjerëve që kryejnë janë të përfshira në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e tyre janë të tilla dhe baza ligjore faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo - diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të të gjitha këto procedurale dhe qenësore të ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e ekspertëve.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit te mbetet ne fuqi vendimi i AK, sepse aplikimi i devijimeve te vogla siç përcakton edhe legjislacioni ne fuqi konkretisht neni 59 par. 4 te LPP-së, ku përgjegjesin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet ne përgjegjesi dhe diskrecion te Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në

një çmim me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: